

Raporti i vitit 2020 për Liritë Fetare Ndërkombëtare: Kosova

Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon liri fetare që u nënshtrohen kufizimeve për të siguruar rend publik, shëndet dhe siguri ose për t'i mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ligji nuk parashikon ndonjë mënyrë që grupet fetare të fitojnë status juridik. Në shtator, kabineti miratoi ndryshime që do t'ua siguronin grupeve fetare një status të tillë dhe do t'u mundësonin ta zhvillonin biznesin në emrin e tyre dhe të fitonin përfitime të caktuara tatimore, por parlamenti nuk i miratoi ato për shkak të mungesës së kuorumit të kërkuar për ta miratuar legjislacionin. Sipas Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), në shumë raste, shkollat fillore publike ua mohuan nxënëseve myslimane me veshje fetare ndjekjen e mësimet. Më 4 shtator, Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë nënshkruan një listë të angazhimeve në Uashington, D.C., të ndërmjetësuar në Shtëpinë e Bardhë, që përfshinte një premtim për ta mbrojtur dhe promovuar lirinë e fesë, për ta përtërirë komunikimin ndërfetar, për t'i mbrojtur vendet fetare, për t'i zbatuar vendimet gjyqësore në lidhje me Kishën Ortodokse Serbe (KOS) dhe për ta vazhduar kthimin e pronës hebraike të patrashëguar dhe të pakërkuar të kohës së Holokaustit. KOS-i tha se mungesa e komunikimit konstruktiv me disa qeveri komunale i pengoi pelegrinët ortodoksë serbë të kishin qasje të lirë në disa tempuj dhe varreza të KOS-it. KOS-i tha se qeveria dështoi ta zbatonte plotësisht Ligjin mbi Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM) duke dështuar ta parandalojë ndërtimin e rrugëve në ZVM të Manastirit të Deçanit. Qeveria ndaloi punën në ZVM në gusht pas kundërshtimeve nga komuniteti ndërkombëtar. Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM), që përfshin KOS-in, vendosi në nëntor për rehabilitimin e rrugës në përputhje me ligjin. Autoritetet lokale dhe qendrore vazhduan ta shpërfillnin një vendim të gjykatës të vitit 2016 mbi pronësinë e KOS-it për disa parcela të tokës pranë manastirit të Deçanit. Pas një rishikimi, qeveria deklaroi në gusht se, në shumë varreza të menaxhuara nga BIK-u sipas kontratave komunale, mungesa e mbikëqyrjes komunale i mundësoi BIK-ut që të parandalonte grupe të tjera fetare/jo-fetare të kryenin shërbime varrimi sipas besimeve të tyre dhe t'i diskriminonin grupet e pakicave fetare. Komunitetet serbe dhe hebraike të Kosovës thanë se disa komuna nuk i mirëmbajtën siç duhet varrezat e këtyre komuniteteve.

Policia kombëtare tha gjatë këtij vitit kishte pranuar raporte për 57 incidente kundër vendeve fetare ose varrezave, krahasuar me 61 incidente në vitin 2019. Policia i klasifikoi shumicën e incidenteve si vjedhje, ndonëse disa përfshinin dëmtime në varreza ose prona të tjera. Shumica e incidenteve i kishin në shënjestër vendet e bashkësisë myslimane, ndonëse disa përfshinin pronat e KOS-it dhe të kishës katolike. Sipas KOS-it, shumë incidente që përfshinin vendet fetare të KOS-it ishin të lidhura me përkatësinë etnike serbe dhe fenë, por kishte edhe incidente që nuk u raportuan në polici. Në gusht, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) njoftoi se vandalët dëmtuan një kishë të KOS-it në fshatin Sreçkë në Prizren. Në shtator, sipas mediave dhe policisë, një kishë e KOS-it u grabit në Babimoc të Obiliqit. Më 6 janar, në Gjakovë, shqiptarët lokalë të Kosovës, përfshirë familjet e personave të zhdukur nga konflikti i vitit 1998-1999, organizuan një protestë, siç kishin bërë që nga viti 2015, para kishës lokale të KOS-it, që përsëri i detyroi anëtarët e KOS-it ta anulonin një pelegrinazh atje. Zyrtarët e KOS-it përsëri u ankuan për raportim negativ të mediave dhe kritika ndaj kryemurgut të Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq, si pretendimet se kryemurgu po e bllokonte zhvillimin lokal duke ia mohuar komunës së Deçanit përdorimin e pronës dhe burimeve të veta.

Zyrtarët e Ambasadës Amerikane vazhduan ta inkurajojnë qeverinë të miratojë ndryshime që u lejojnë grupeve fetare ta fitojnë statusin ligjor, t'i zbatojnë mekanizmat për ta mbrojtur lirinë e fesë, ta zbatojnë legjislacionin dhe vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me vendet fetare të

KOS-it dhe t'i zgjidhin kontestet pronësore të KOS-it. Ambasadori dhe përfaqësues të tjerë të ambasadës i diskutuan çështjet e lirisë fetare, përfshirë mbrojtjen e barabartë dhe çështjet e të drejtave pronësore, me udhëheqësit fetarë dhe të shoqërisë civile dhe inkurajuan tolerancën fetare dhe dialogun e përmirësuar ndërfaqetare.

Seksioni I. Demografia fetare

Qeveria e SHBA-së vlerëson se numri i përgjithshëm i popullsisë është 1,9 milionë banorë (vlerësim i mesit të vitit 2020). Sipas regjistrimit të vitit 2011 (më i fundit), 95,6 për qind e popullsisë është myslimane, 2,2 për qind katolike romane dhe 1,4 për qind serbe ortodokse, me protestantë, hebrej dhe persona që nuk përgjigjeshin ose u përgjigjën “tjetër” ose “asnje”, që së bashku përbënin më pak se 1 për qind. Sipas KOS-it dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, mungesa e mbështetjes financiare për regjistrim dhe bojkotimi i tij nga shumica e serbëve etnikë rezultoi në llogaritje më të ulët të pakicave etnike të të gjitha prejardhjeve fetare, përfshirë anëtarët e KOS-it, tarikatet myslimane dhe protestantët. Komunitetet e tjera fetare, përfshirë tarikatet myslimane dhe protestantët, gjithashtu i kundërshtuan të dhënat e regjistrimit, duke theksuar se nuk kishin besim në metodologjinë e regjistrimit dhe besuan që kjo rezultoi në llogaritje të ulët të anëtarëve të komuniteteve të tyre.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë myslimanë, ndonëse disa janë të krishterë (ortodoksë, katolikë dhe protestantë). Pothuaj të gjithë serbët e Kosovës i takojnë KOS-it. Shumica e ashkalinjve, boshnjakëve, egjiptianëve, goranëve, romëve dhe turqve janë gjithashtu myslimanë, ndërsa shumica e malazezëve etnikë dhe disa romë janë ortodoksë të krishterë. Pothuaj të gjithë kroatët etnikë janë katolikë.

Sipas BIK-it, shumica e myslimanëve i përkasin shkollës sunite hanafi, edhe pse disa janë pjesë e komunitetit tarikat sufi. Ekziston edhe një komunitet fetar sufi bektashi; nuk ka asnjë vlerësim zyrtar për numrin e pasuesve të tij. Shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën në 28 nga 38 komuna të vendit dhe serbët e Kosovës përbëjnë shumicën në 10 komunat e tjera. Pjesa më e madhe e anëtarëve të KOS-it banojnë në 10 komunat me shumicë serbe. Komunitetet më të mëdha katolike janë në Gjakovë, Janjevë, Klinë, Prishtinë dhe Prizren. Popullatat protestante ungjillore janë të vendosura në tërë vendin, të përqendruara në Prishtinë dhe në Gjakovë. Ka komunitete të vogla hebraike në Prizren dhe Prishtinë.

Seksioni II. Statusi i respektimit të lirisë fetare nga Qeveria

KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta parashikon të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për ta ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fetar, për ta ushtruar fenë apo për të mos e ushtruar fenë, dhe për t'iu bashkuar apo refuzuar për t'iu bashkuar një bashkësie fetare. Këto të drejta u nënshtrohen kufizimeve për shkak të sigurisë dhe rendit publik ose për ta mbrojtur shëndetin apo të drejtat e të tjerëve. Kushtetuta parashikon ndarjen e bashkësive fetare nga institucionet publike, përfshirë të drejtën e grupeve fetare për t'i rregulluar në mënyrë të pavarur organizimet, aktivitetet dhe ceremonitë e tyre, dhe të drejtën për të themeluar shkolla fetare dhe institucione bamirësie. Ajo garanton të drejta të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, përcakton që vendi është shtet laik dhe neutral lidhur me fenë, deklaron që shteti do ta sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë fetare të vendit dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe. Kushtetuta përcakton që ligji mund ta kufizojë lirinë e shprehjes për ta parandaluar provokimin e dhunës dhe armiqësisë për shkak të racës,

nacionalitetit, përkatësisë etnike apo fesë. Ajo u lejon gjykatave t'i ndalojnë organizimet apo aktivitetet që inkurajojnë urrejtje racore, nacionale, etnike apo fetare.

Ligji për lirinë fetare thotë, “Të gjitha besimeve dhe bashkësive të tyre në Kosovë duke përfshirë Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Ortodokse Serbe, Kishën Katolike, Bashkësinë e Besimit Hebrej, dhe Kishën Evangjeliste (pesë komunitetet “tradicionale” fetare), do t'u ofrohet çdo lloj mbrojtjeje dhe mundësi për të gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuar me këtë Ligj.” Kushtetuta parashikon të drejta dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët, përfshirë mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ruajtjen e fesë së tyre duke përdorur gjuhën e tyre. Kushtetuta gjithashtu thotë se bashkësitë fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirësie me mundësinë e financimit me ndihmë financiare të qeverisë “në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare”. Kushtetuta ofron garanci të lirisë dhe pluralizmit të mediave. Ajo u garanton të gjitha komuniteteve etnike qasje në mediat publike. Të drejtat shtesë për grupet fetare përfshijnë themelimin dhe përdorimin e mediave të tyre, mbajtjen e kontakteve paqësore e të papenguara me personat jashtë vendit me të cilët ndajnë identitet fetar dhe qasjen e barabartë në punësimin publik.

Kushtetuta ua garanton 20 nga 120 vende në parlament përfaqësuesve të bashkësive të pakicave etnike, të cilat shpesh shoqërohen me një grup fetar me shumicë të vetme, si myslimanët ose të krishterët ortodoksë. Ajo gjithashtu përcakton miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me lirinë fetare ose trashëgiminë kulturore, kërkon miratimin nga shumica e deputetëve që i përfaqësojnë komunitetet e pakicave, si dhe nga shumica e të gjithë deputetëve.

Kushtetuta parashikon Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës për monitorimin e lirisë fetare, ndër të drejta të tjera të njeriut, dhe për rekomandim të veprimeve për t'i korrigjuar shkeljet. Kushtetuta përcakton që shteti do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur individët që mund të jenë subjekt i kërcënimit, armiqësisë, diskriminimit apo dhunës për shkak të identitetit të tyre fetar.

Ligji përcakton që nuk ka fe zyrtare, por i rendit pesë bashkësi “tradicionale” fetare që marrin mbrojtje dhe përfitime shtesë, përfshirë taksat e reduktuara.

Ligji nuk kërkon regjistrimin e grupeve fetare, por as nuk parashikon ndonjë mekanizëm ligjor ose udhëzim specifik që grupet fetare të fitojnë status ligjor përmes regjistrimit apo mënyrave të tjera. Pa status ligjor, komunitetet fetare nuk mund të posedojnë pronë, të hapin llogari bankare, të punësojnë personel, të kenë qasje në gjykata si entitet. Mirëpo kongregacionet individuale ose individët mund të hapin llogari bankare, të punësojnë personel, të kenë qasje në gjykata apo të kryejnë punë të tjera administrative në emër të tyre. Komunitetet lokale shpesh njohin posedimin e ndërtesave nga grupet fetare; megjithatë, ligji në përgjithësi nuk i mbron këto ndërtesa si pronë të një komuniteti fetar, por përkundrazi si pronë private të qytetarëve ose të organizatave joqeveritare. Prona e KOS-it bën përjashtim: Ligji për ZVM-në e pranon dhe e mbron integritetin e pronësisë së pronave të KOS-it dhe kujdestarinë për zona të caktuara në kuadër të ZVM-ve.

Ligji parashikon lirinë e praktikave fetare ose jofetare dhe të drejtën për të krijuar organizata humanitare/bamirësie, pranimin e kontributeve vullnetare financiare nga individë dhe institucione, dhe përfshirjen në komunikim kombëtar dhe ndërkombëtar për qëllime fetare.

Ligji parashikon mbrojtje për vendet me rëndësi fetare e kulturore dhe ndalon ose kufizon aktivitetet në afërsi që mund ta dëmtojnë mjedisin e tyre historik, kulturor apo natyror. Sipas ligjit, KZM është përgjegjës për gjykimin e kontesteve ndërmjet Qeverisë dhe KOS-it lidhur me ZVM-të dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare e kulturore të KOS-it. KZM-ja është organ i posaçëm që rrjedh nga Propozimi Gjithëpërfshirës i vitit 2007 për zgjidhjen e statusit të Kosovës (i njohur si Plani i Ahtisaarit) dhe i themeluar me ligj. Anëtarë të KZM-së janë: Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit (bashkëkryesuese); Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (bashkëkryesues); Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; KOS-i, dhe OSBE-ja.

Komunat janë ligjërisht përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe meremetimin e të gjitha varrezave publike, përfshirë varrezat e caktuara për bashkësitë specifike fetare.

Sipas ligjit, “institucionet e arsimit publik duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose aktivitetet e tjera që përhapin fe specifike”. Ky ligj nuk zbatohet në shkollat që veprojnë nën strukturat paralele të udhëhequra nga Qeveria e Serbisë, mbi të cilat Qeveria e Kosovës nuk ka kontroll.

Një qarkore administrative e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për kodin e sjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, me fuqi të ligjit, ua ndalon nxënësve të mbajnë “uniforma” fetare në ambientet e shkollave fillore e të mesme.

Vendi nuk është palë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike.

Praktikat qeveritare

Në shtator, kabineti miratoi dhe dërgoi në parlament ndryshime në Ligjin për lirinë fetare që do t'u lejonte grupeve fetare ta fitonin statusin ligjor, të bënin biznes dhe të merrnin prona të paluajtshme e personale në emrin e tyre, të hapnin llogari bankare dhe të fitonin përfitime nga taksat e importit. Në fund të vitit, parlamenti nuk kishte votuar për ndryshimet; kishte një mungesë të vazhdueshme të kuorumit për shkak të pandemisë COVID-19 dhe bojkoteve nga deputetët serbë të Kosovës. Në mungesë të zbatimit të legjislacionit, të gjitha bashkësitë fetare thanë që vazhduan të operonin llogari bankare të regjistruara në emër të individëve në vend të bashkësive. Përveç kësaj, komunitetet, si Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës (KPUK), thanë që vazhduan të tatheshin si biznese fitimprurëse.

Sipas BIK, ka pasur shumë raste në të cilat shkollat fillore ua mohuan hyrjen nxënësve myslimane si rezultat i zbatimit të qarkores administrative të MASH-it që ndalonte “veshjen fetare” në pronën e shkollës. Imami Labinot Maliqi, drejtor ekzekutiv i organizatës joqeveritare “Qendra Kosovare për Paqe”, raportoi se dy nxënësve të shkollës fillore, njëra në Fushë Kosovë dhe tjetra në Gjakovë, u ishte ndaluar hyrja në shkollë për shkak të mbajtjes së hixhabit. Zyrtarët e shkollës e prapësuan vendimin e tyre pasi Qendra Kosovare për Paqe e hetoi këtë situatë. Në korrik, sipas Maliqit, zyrtarët e MASH-it i thanë se MASH-i zotohej ta rishikonte ndalimin e veshjeve fetare. Ndalimi mbeti në fuqi në fund të vitit.

Përfaqësuesit e komunitetit mysliman thanë se gjatë vitit pati raste të diskriminimit në punësim ndaj grave myslimane që vishnin rroba fetare, por nuk përmendën ndonjë shembull.

Më 4 shtator, Kosova dhe Serbia nënshkruan listat e angazhimeve në Uashington, D.C., në të cilat qeveria e Kosovës u zotua ta mbrojë dhe promovojë lirinë e fesë, përfshirë komunikimin

e përtërirë ndërftuar, mbrojtjen e vendeve fetare dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me KOS-in, dhe ta vazhdojë kthimin e pronës hebraike të patrashëguar dhe të pakërkuar të kohës së Holokaustit.

Zyrtarë komunalë të Deçanit vazhduan ta refuzojnë zbatimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, që e mbështeste aktvendimin e Gjykatës Supreme të vitit 2012, që ia njihte pronësinë Manastirit të Deçanit të KOS-it për afro 24 hektarë tokë në afërsi të manastirit. Në nëntor, KOS-i u ankua në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; vendimi i saj nuk ishte zgjidhur në fund të vitit. Trupat e NATO-s vazhduan të ofronin siguri në Manastirin e Deçanit.

Në gusht, komuna e Deçanit filloi punën në rrugë brenda ZVM-së së Manastirit të Deçanit në kundërshtim me ligjin. Qeveria e ndaloi punën pas kritikave ndërkombëtare. Në nëntor, KPM-ja dhe qeveria komunale e Deçanit miratuan një marrëveshje të ndërmjetësuar nga Italia që i përmbahej ligjit për rehabilitimin e rrugës. Marrëveshja përfshiu ndërtimin e një rruge anësore jashtë kufijve të ZVM-së, e cila do ta lidhte Deçanin me Malin e Zi, dhe të një rruge të veçantë lokale brenda ZVM-së. Puna e propozuar e rrugës nuk kishte filluar deri në fund të vitit.

Në korrik, Komuna e Prishtinës lëshoi një leje ndërtimi dhe filloi ndërtimin e një xhamie të madhe në Prishtinë, të financuar nga qeveria turke. Disa qytetarë e kundërshtuan ndërtimin e kësaj xhamie, duke thënë se dizajni i saj bazohet në një stil arkaik osman, e jo në arkitekturën tradicionale të xhamive në Kosovë. Disa hoxhallarë lokalë vazhduan të deklaronin se xhamitë ekzistuese në qytet i përmbushnin nevojat e anëtarëve të tyre dhe nuk kishte nevojë për një xhami kaq të madhe në këtë zonë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) raportoi se 23 nga 38 vendet e qeverisjes komunale kishin kontrata shërbimi me BIK-un për të ofruar shërbime të rregullimit, mirëmbajtjes dhe varrosjes në varrezat publike. Sipas MAPL-së, prania e një imami hanafi në një varrim në varrezat e administruara nga BIK-u shpesh konsiderohej e detyrueshme. Disa bashkësi fetare dhe etnike, veçanërisht myslimane jo-hanafi si shia dhe bektashi, si dhe protestantë dhe anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, thanë se aftësia e BIK për ta zëvendësuar personelin tjetër fetar në kryerjen e ceremonive të varrimit në varrezat e administruara nga BIK-u i pengoi ata që t'i kryenin ceremonitë e varrimit sipas zakoneve të tyre. MAPL kreu një rishikim gjatë vitit dhe tha se i mbështeste këto shqetësime. Ajo gjithashtu deklaroi se, në shumë varreza të menaxhuara nga BIK-u, mungesa e mbikëqyrjes komunale i mundësoi BIK-ut t'i diskriminonte grupet fetare të pakicave në caktimin e parcelave të varrimit dhe në ofrimin e shërbimeve të tjera. MAPL shtoi se BIK-u gjithashtu kushtëzoi kryerjen e një ceremonie varrimi me pagesën e tarifave të anëtarësisë vjetore që ndryshonin sipas komunave prej dy deri në gjashtë euro (\$2-\$7) në vit për person, që përfshinte pjesëmarrjen e një imami dhe kryerjen e riteve fetare islame. MAPL bëri thirrje që komunat t'i përfshijnë të gjitha bashkësitë fetare lokale në diskutimet e kontratave dhe që kontratat të siguronin trajtim të barabartë për të gjitha grupet. Komunitetet katolike, krishtere ortodokse dhe hebraike të Prishtinës vazhduan të përdornin varreza të ndara publike të cilat këto grupe i mirëmbanin dhe operonin në mënyrë të pavarur.

KOS-i dhe komuniteti serb i Kosovës vazhduan të deklarojnë se në shumë komuna të Kosovës me shumicë shqiptare, qeveritë lokale nuk ofruan mirëmbajtje adekuate për varrezat e tyre dhe policia nuk ofroi siguri të mjaftueshme, duke lejuar veprime të shpeshta të vandalizmit. Sipas njoftimeve të mediave në gjuhën serbe në shkurt, varrezat ortodokse me gurë varresh të dëmtuar dhe bar të keq të rritur shumë ishin të rëndomta në disa zona të vendit. Disa media gjithashtu deklaruan se serbët e zhvendosur i transferonin mbetjet mortore të të ndjerëve të tyre

në varrezat në Serbi. Në qershor, për shembull, ati Sava shkroi në Twitter se gjendja e varrezave të KOS-it në zonat me shumicë shqiptare të Kosovës ishte edhe më e keqe se mënyra se si OSBE-ja e kishte përshkruar në një raport të vitit 2011, në të cilin deklaroi se 392 varreza serbe ishin në gjendje “të keqe” ose “shumë të keqe”.

Përfaqësuesit e komunitetit hebraik përsëri thanë se qeveritë lokale nuk i mirëmbanin siç duhet varrezat hebraike jashtë Prishtinës, si në Novobërdë, Lipjan, Kamenicë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan, pavarësisht nga detyrimi i tyre ligjor për ta bërë këtë.

Me pëlqimin e qeverisë, OSBE-ja vazhdoi ta monitorojë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ZVM-ve përreth vendeve fetare dhe të trashëgimisë së KOS-it. Njësia e Policisë për Sigurinë e Ndërtesave të Trashëgimisë Fetare e Kulturore vazhdoi të ofronte siguri 24-orëshe për 24 ZVM-të në tërë vendin.

Në fund të vitit, komuna e Prishtinës dhe komuniteti hebraik vazhduan të mos pajtoheshin për një vend të përshtatshëm për një sinagogë për të cilën komuna kishte lëshuar një leje ndërtimi që në vitin 2016.

KOS-i tha se numri i madh i rasteve të pazgjidhura gjyqësore e pengoi përparimin e një padie të ushtruar kundër Universitetit të Prishtinës në vitin 2017. Sipas KOS-it, padia kërkon anulimin e një donacioni të tokës të vitit 1991 nën qeverinë e ish-Jugosllavisë për KOS-in dhe rrënimin e Kishës së papërfunduar, por të shenjtëruar, të Krishtit Shpëtimtar, të ndërtuar në një parcelë të tokës brenda kampusit universitar. Edhe komuna e Prishtinës edhe universiteti e kundërshtuan pronësinë e tokës së KOS-it.

KOS-itha se Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës vazhdoi ta kontestonte pronësinë e KOS-it për pronën që agjencia e kishte përdorur që nga viti 2001. KOS-i theksoi se agjencia i detyrohej qira për përdorimin e pronës. KOS-i mori pagesë të pjesshme për qira në vitin 2018, por nuk mori kompensim të mëtejshëm. Në fund të vitit, as KOS-i dhe as agjencia nuk kishin iniciuar asnjë veprim ligjor për këtë kontest.

Sipas BIK-ut, qeveria qendrore vazhdoi të siguronte disa fonde për arsimin islam në medresenë e BIK-ut në Prishtinë dhe në degët e saj në Prizren dhe Gjilan. Disa anëtarë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës thanë se besonin që ky financim ishte diskriminues sepse qeveria nuk siguroi fonde për arsimin fetar për asnjë grup tjetër fetar.

Sipas MASH-it, serbët etnikë dhe disa boshnjakë, goranë, kroatë dhe romë vazhduan ta vijonin mësimin në shkollat publike në gjuhën serbe të drejtuara dhe të financuara nga strukturat paralele të qeverisë serbe. Shkollat ofruan mësim për ortodoksët e krishterë dhe qeveria serbe i pagoi për mësimdhënësit, të cilët ishin anëtarë të KOS-it. Nxënësve u lejohej të zgjidhnin të mos shkonin nga këto mësim.

KPUK-u theksoi se Zyra e Kosovës për Imigrim vazhdoi ta mohonte njohjen e misionarëve jocosovarë të angazhuar nga kisha. KPUK-u tha se Shërbimi Doganor kërkoi pagesën e 3,393 eurove (\$4,200) në taksa për ndihmën humanitare që KPUK-u e kishte marrë nga jashtë gjatë vitit, ndërsa disa bashkësi të tjera fetare, si BIK-u, ishin të liruar nga taksat. KPUK-u tha se Shërbimi Doganor vazhdoi të këmbëngulte në pagimin e taksës përkundër ndërhyrjes nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj në vitin 2019. Përveç kësaj, sipas KPUK-ut, disa biznese nuk e respektuan lirin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për mallrat e blera nga kishat e tyre për shkak të paragjyqimeve fetare.

KOS-i vazhdoi të ankohej për deklaratat publike të bëra nga udhëheqja komunale e Deçanit kundër atit Sava të Manastirit të Deçanit për kundërshtimin e tij për ndërtimin e paligjshëm të rrugëve brenda ZVM-së së Deçanit.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit theksoi se hoqi dorë nga pagesa e shërbimeve për ujë për ndërtesat fetare që u takojnë të gjitha bashkësive fetare, për dallim nga viti paraprak, kur i faturoi disa bashkësi fetare, si protestantët dhe tarikatet.

Seksioni III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë fetare

Policia kombëtare raportoi për 57 incidente që synonin vendet fetare gjatë vitit, krahasuar me 61 incidente në vitin 2019. Të gjitha incidentet ishin kundër pronës. Prej këtyre 57 incidenteve, 45 ndodhën në vendet myslimane, tetë në vendet e KOS-it dhe tri në vendet katolike, ndërsa një kishte në shënjestër pronën që nuk i përkiste ndonjë grupi specifik fetar. Policia i klasifikoi shumicën e 56 incidenteve të tjera si vjedhje, ndonëse disa përfshinin dëmtime të varrezave ose pronave të tjera. Pati edhe incidente që përfshinin vendet fetare, por që nuk u raportuan në polici. Policia nuk e klasifikoi asnjë nga 57 incidentet e raportuara si incident me motive fetare. Megjithatë, KOS-i deklaroi se disa nga incidentet që përfshinin pronën e saj në Kosovë ishin me motive fetare dhe etnike. Pasi feja dhe përkatësia etnike shpesh janë të lidhura ngushtë, nganjëherë ishte vështirë të kategorizoheshin incidentet si incidente të bazuara në identitet fetar

KOS-i përsëri deklaroi se raportimi i mediave i kontribuoi një klimë të jotolerancës ndëretnike dhe ndërfetare gjatë vitit. Për shembull, në shtator, dioqeza e kryepeshkopit të KOS-it për Rashkë-Prizren lëshoi një komunikatë për shtyp me të cilën e dënonte një artikull në gazetën *Koha Ditore* nga profesori i historisë Bedri Muhadri. Në komunikatën për shtyp thuhej që pretendohet pa prova se vendet e shenjta të KOS-it në Kosovë ishin në të vërtetë kisha mesjetare shqiptare dhe të uzurpuara katolike romake.

BIK-u përsëri deklaroi se kishte raporte në media dhe deklarata në mediat sociale që i portretizonin negativisht myslimanët. Në korrik, një kolumnist i gazetës dënoi mbështetjen e fortë publike për ndërtimin e xhamisë së madhe në Prishtinë, duke shkruar se myslimanët në vend “nuk kanë më asnjë lidhje me ilirët”, dhe duke shtuar se “investimi në xhami po e largon Kosovën nga rruga e saj evropiane.”

BIK raportoi për një rast të një gruaje myslimane që iu mohua kontrata e punës në sektorin privat, por nuk dha detaje. BIK-u tha se gratë e përkushtuara myslimane ngurren t'i raportonin rastet e diskriminimit në baza fetare.

Më 6 janar, në Gjakovë, shqiptarët lokalë të Kosovës, përfshirë familjet e personave të zhdukur nga konflikti i vitit 1998-99, organizuan një protestë para kishës lokale të KOS-it, ku anëtarët e KOS-it, serbë të zhvendosur të Kosovës, e kishin planifikuar një pelegrinazh në krishtlindjet ortodokse. Mediat raportuan se organizatorët përsëri e anuluan pelegrinazhin, duke përmendur shkaqet e sigurisë. Protesta të tilla janë mbajtur që nga viti 2015.

Në gusht, vandalët dëmtuan një kishë të KOS-it në fshatin Sreçkë në Prizren. Në shtator, mediat raportuan se një kishë e KOS-it ishte përdhosur dhe vjedhur në Babimoc në Obiliq.

Pati raportime për incidente të vandalizmit gjatë gjithë vitit në varrezat serbe. Mediat në gjuhën serbe raportuan se më 10 janar, një person i panjohur vendosi një flamur shqiptar në gardhin

përreth një varreze serbe në Livoç të Epërm, afër komunës së Gjilanit. Në shkurt, mediat në gjuhën serbe raportuan se individë të panjohur vandalizuan një varrezë serbe në fshatin Zac në komunën e Istogut në prag të një shërbimi përkujtimor. Sipas mediave, vandalët rrëzuan dhe thyen monumente, prenë pemë të vjetra me shekuj që më pas ranë në varreza, dhe e hoqën gardhin. U raportua se edhe kisha në varreza ishte dëmtuar. Në nëntor, mediat në gjuhën serbe raportuan se disa monumente u shembën në një varrezë serbe në fshatin Frashër, afër Mitrovicës së jugut, para një shërbimi përkujtimor. Sipas raporteve të mediave, në qershor, një grup i serbëve të Kosovës vizitoi një varrezë në Mitrovicën e jugut, ku më shumë se 80 për qind e gurëve të varreve ishin shkatërruar. Disa media publikuan edhe fotografi të varrezave, duke treguar gurë të thyer të varrezave dhe gjethnaja të rritura shumë.

Në prill, gurët e varreve në varrezat e anëtarëve të komuniteteve etnike rome, ashkallike dhe egjiptiane u thyen në komunën e Rahovecit. Kryetari Smajl Latifi publikisht e dënoi këtë incident dhe bëri thirrje për ndërhyrje të menjëhershme të policisë për gjetjen e autorëve. Ish-Ministri për Komunitete dhe Kthime, Dallibor Jevtiq, iu referua rasteve të mëparshme në komunë dhe u zotua t'i mbështesë familjet e prekura nga incidenti. OSBE-ja gjithashtu i dënoi këto akte.

Në dhjetor, zyrtarët komunalë të Skenderajt raportuan se vandalët shkatërruan një pllakë të shkruar me fjalët “Kisha jonë” në qytetin Gjyteti i Syriganës. Ky objekt është një vend i trashëgimisë kulturore i mbrojtur nga shteti. Asnjë grup specifik fetar nuk e pretendoi pronësinë e pllakës.

Sipas zyrtarëve të kishës katolike, raportet e vitit 2019 për shkatërrimin e simboleve fetare në një kishë katolike në fshatin Janjevë dolën të ishin të pasakta.

Udhëheqja e BIK-ut theksoi se një grup i qytetarëve të Mitrovicë lloboi për rindërtimin e një xhamie në Mitrovicën e veriut, të cilën forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë e kishin shkatërruar në vitin 1999, por që kundërshtimi nga serbët lokalë të Kosovës vazhdoi t'i pengonte planet e rindërtimit.

Udhëheqësit e grupeve fetare i vazhduan diskutimet ndërfaqetare për të drejtat pronësore, prioritetet legjislative dhe çështjet e bashkësive lokale. OSBE-ja vazhdoi t'i koordinonte disa aktivitete midis grupeve fetare, përfshirë takimet me autoritetet qendrore e lokale, për t'i diskutuar çështjet si mirëmbajtja e varrezave, lirimi nga tatimi dhe taksat doganore për aktivitetet humanitare të bashkësive fetare, dhe ndryshimet në Ligjin për lirinë fetare. Një rezultat i këtij angazhimi ishte mirëmbajtja e përmirësuar e varrezave nga disa qeveri komunale. OSBE-ja gjithashtu mbështeti përfshirjen e përfaqësuesve të të gjitha bashkësive kryesore fetare në këshillat komunale për siguri në bashkësi, të cilët u takuan për t'i diskutuar çështjet e sigurisë.

Seksioni IV. Politika dhe angazhimi i Qeverisë Amerikane

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të Ambasadës diskutuan dhe biseduan me Kryeministrin dhe Zëvendëskryeministrin, zyrtarë nga MASH-i, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, dhe udhëheqësit e partive politike nga Partia Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lista Serbe për miratimin e ndryshimeve në Ligjin për lirinë fetare që do t'u lejonin grupeve fetare ta fitonin statusin ligjor. Ata gjithashtu nxitën zyrtarët e qeverisë që ta respektojnë lirinë fetare dhe pluralizmin dhe ta rrisin komunikimin e tyre me grupet fetare. Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të Ambasadës u kërkuan zyrtarëve të qeverisë

qendrore dhe lokale, përfshirë Kryeministrin, që ta respektojnë ligjin për ZVM-të, veçanërisht në rastin e rrugës pranë Manastirit të Deçanit. Zyrtarët e Ambasadës biseduan me të gjitha nivelet e qeverisë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që urdhëronte regjistrimin e pronësisë së 24 hektarëve tokë të Manastirit të Deçanit, duke nxitur qeverinë dhe gjyqësorin që t'i mbanin përgjegjës zyrtarët lokalë.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës kërkuan rritjen e dialogut ndërmjet anëtarëve shqiptarë etnikë të qeverisë – përfshirë Kryeministrin – dhe të shoqërisë civile me anëtarët e KOS-it. Ata e përcollën këtë mesazh në takimet private dhe në deklaratat publike, duke bërë thirrje për bashkëpunim ndërmjet qeverive lokale dhe KOS-it për çështje si pronësia e pronës, të drejtat e njeriut, liria fetare dhe siguria e përgjithshme.

Zyrtarët e Ambasadës u takuan me të gjitha bashkësitë kryesore fetare dhe i diskutuan ndryshimet në Ligjin për lirinë fetare, çështjet sociale me interes të përbashkët, çështjet e lirisë fetare dhe marrëdhëniet qeveritare me bashkësitë fetare. Ambasada gjithashtu financoi dialogun ndërfetar ndërmjet të rinjve të të gjitha grupeve kryesore fetare dhe organizatave jofetare në vend.

Ambasada shpesh postoi porosi në mediat sociale në mbështetje të lirisë fetare, për shembull, duke shënuar Ditën Ndërkombëtare të Lirisë Fetare më 27 tetor, duke i bërë thirrje qeverisë që ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për çështjen që përfshin kontestin për tokën e Manastirit të Deçanit, dhe duke i nxitur të gjithë palët që t'i përmbahen ligjit për ZVM-të.